



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. _____ Prot../A.Xh

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

BISEDIME PËRFUNDIMTARE

“Në lidhje me çështjen (JR) Nr. 12/2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Habazaj”

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë **z. Altin Dumani** si dhe nga prokurori **z. Adnan Xholi** (*me autorizim*).

Objekti: Bisedime përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancë gjyqësore, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit me Nr. 736, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, **z. Gentian Habazaj**.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: **14.10.2025**

Përpara: **GJYKATËS KUSHTETUESE**

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TIRANË

Faqe 1 nga 9

E nderuar znj. kryesuese e Trupit Gjykses!

Të nderuar gjyqtarë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit të datës 13.3.2024, prapësimet dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në funksion të shkaqeve të ankimit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara dhe nivelit të provueshmërisë së tyre në lidhje me shkaqet e ankimit, parashtrohet si vijon:

I. A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerëson të ndalet fillimisht, sa i takon konstatimit në ankim, mbi informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (këtu e në vijim DPPP), drejtuar Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së¹, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit², informacion i përcjellë edhe në Komision, në kuadër të hetimit administrativ të kryer nga ky i fundit. Lidhur këtë informacion, vlerësojmë se sikundër ka rezultuar edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në raport me çfarë raportohet nga kjo Drejtori, nuk rezultuan transaksione të vetë subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, sipas parashikimeve të nenit 3 pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për të cilat, organet përgjegjëse kishin ngritur dyshime. Gjithashtu, nuk rezultuan hetime apo përfundime të mëtejshme nga organet përgjegjëse ligjzbatuese, për transaksionet e raportuara të kryera nga prindërit e subjektit të rivlerësimit.

2. Sa i përket shkaqeve të ankimit lidhur me pasuritë: *Depozitë bankare pranë *** Bank në vlerën 4.800.000 lekë dhe kursime në cash në vlerën 700.000 lekë*³, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit të çështjes në Komision, ritheksoi se pasuria depozitë bankare, e deklaruar fillimisht në deklarin e tij të parë si subjekt deklarues në vitin 2009⁴, ka si burim të ardhurat e prindërve nga punësimi dhe aktiviteti i tyre, duke theksuar edhe njëherë faktin se subjekti i rivlerësimit në kohën e krijimit të kësaj depozite, (viti 2003), ka qenë student.

2.1 Sa i përket çështjeve të trajtuara në ankim, lidhur me *pamjaftueshmërinë financiare të prindërve* për krijimin e pasurisë depozitë, subjekti ka kundërshtuar shkaqet e ankimit

¹ Me shkresën nr. ***/** prot., datë **.4.2017.

² Me shkresën nr. ***/**, datë **.1.2017.

³ Për kursimet cash, subjekti ka deklaruar se kanë si burim kursimet nga paga si prokuror dhe diferenca e mbetur nga tërheqja e po kësaj depozite bankare.

⁴ Dorëzuar në ILDKPKI në datën **.11.2009.

dukë vënë në dispozicion akte të administruara në cilësinë e provës, konkretisht: (i) 52 vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë, të periudhës **.1.2005 deri **.12.2006, ku i ati rezulton si avokat mbrojtës i palëve në proces, në funksion të shkakut ankimor mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i të atit për vitet 2005 dhe 2006, si dhe (ii) *kërkesë për hapje llogarie rrjedhëse depozitë bankare, pranë ***-**, dt. **.9.2009 dhe statement bankar*⁵, në funksion të shkakut ankimor mbi investime të prindërve në sistemin bankar në kuadër të analizës së likuiditeteve të prindërve për periudhën e analizuar.

2.2 Në përfundim të këtij gjykimi, pasi u vlerësuan aktet e depozituara në funksion të shkaqeve të ankimit, në raport me parashtrimet e subjektit gjatë seancës në Kolegj, nisur nga specifikat e rastit mbi *mënyrën dhe kohën e krijimit të pasurisë depozitë* në emër të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se vijon:

2.2.1 Subjekti i rivlerësimit, ka ndjekur Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës 2007-2009, është emëruar prokuror *në stazh* në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durës më tetor 2009 dhe ka depozituar në ILDKPKI deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në datën 25.11.2009. Në momentin e plotësimit dhe dorëzimit të Deklaratës Vetting, subjekti i rivlerësimit rezulton i shkëputur nga trangu familjar, për një periudhë prej më shumë se 6 vitesh. Në këto kushte referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit⁶ prindërit e subjektit nuk konsiderohen persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit, duke mos mbartur të njëjtin detyrim ligjor për të justifikuar pasuritë dhe burimet e ligjshme të krijimit të tyre.

2.2.2 Pasuria *depozitë bankare*, në emër të subjektit të rivlerësimit e deklaruar në Deklaratën Vetting dhe në deklarin e parë të subjektit pranë ILDKPKI-së, është një pasuri e krijuar herët në kohë, e provuar dhe materializuar në sistemin bankar që në vitin **2003**, nëpërmjet depozitimit të parë në cash në vlerën 500.000 lekë, në datën 13.6.2003, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit ka qenë duke ndjekur studimet universitare. Në këtë depozitë bankare, konfirmohen depozitime në cash (kryesisht në vitet 2003-2006) dhe shtesa të herëpashershme, deri sa arrihet shuma e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e parë para fillimit të detyrës, 5.400.082 lekë. Për këto depozitime kryesisht identifikohet si depozitues *vetë i ati* i subjektit të rivlerësimit⁷.

2.2.3 Si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, u provua *ekzistenca e aktivitetit të ligjshëm të të atit të subjektit* të rivlerësimit

⁵ Për llogaritë me nr. *** ***, nr. *** ***, nr. *** ***.

⁶ Referohu vendimit të Kolegjit [Nr. 20/2023 \(JR\) datë 3.5.2023](#).

⁷ Subjekti i rivlerësimit identifikohet si depozitues në këtë depozitë bankare, për herë të parë në datën **.9.2006 nëpërmjet një konvertimi nga një llogari tjetër bankare e tij, e krijuar po nga depozitim i shtetasit *** ***, dhe në datën **.12.2009, pas fillimit të stazhit si prokuror, nëpërmjet depozitimit të shumës 25.000 lekë.

dhe ushtrimi i profesionit të tij si avokat, që nga regjistrimi si person fizik në Gjykatën e Rrethit, Vlorë, në vitin 1998, vazhdimësia e aktivitetit deri në vitin 2015 dhe shlyerja e detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shoqëror e shëndetësor si person fizik, elemente këto që tregojnë se ai e ka ushtruar këtë aktivitet në mënyrë të ligjshme, duke e deklaruar në organet përgjegjëse. Të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet janë deklaruar se janë përdorur si burim për financimin e një pasurie që provohet se është krijuar gjatë të njëjtës periudhë. Aktet e depozituara nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, vendimet gjyqësore të periudhës 2005-2006, parë në harmoni edhe me konfirmimet e organeve përgjegjëse mbi mungesën e detyrimeve tatimore të biznesit të të atit, provojnë vazhdimësinë e aktivitetit të avokatisë nga babai i subjektit të rivlerësimit edhe për këto vite, ndërkohë që mbeti e paprovuar shuma e të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet, për të njëjtën periudhë.

2.2.4 Krijimi i kursimeve dhe ruajtja/investimi i tyre në sistemin bankar, ndër vite, nga prindërit e subjektit, në periudha edhe më të hershme se viti 2003 kur daton çelja e depozitës objekt kontrolli, sikundër ka rezultuar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, janë fakte që dëshmojnë për ekzistencën e të ardhurave të familjes nga burime të ligjshme ndër vite.

2.2.5 Vitet për të cilat janë konstatuar paqartësi për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i të atit, në funksion të konsiderimin e tyre si të ardhura të ligjshme referuar kërkesave të nenit D të aneksit të Kushtetutës, i përkasin periudhës kur vetë subjekti i rivlerësimit ishte duke ndjekur studimet dhe nuk ushtronte funksione publike, duke përjashtuar tej çdo dyshimi, se ai, subjekti, ka pasur mundësi të ndikojë nëpërmjet abuzimit me detyrën e tij në krijimin e pasurisë.

2.2.6 Subjekti i rivlerësimit, në përputhje me detyrimet e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ka deklaruar rregullisht dhe saktësisht në deklaratat periodike vjetore të viteve 2009-2016 dhe në atë Vetting, depozitën bankare, shtesat, pakësimet dhe çdo ndryshim të mundshëm lidhur me këto kursime, duke lejuar kështu gjurmimin e tyre vit pas viti.

2.3 *Në përfundim*, vlerësohet se problematikat e konstatuara lidhur me këtë pasuri, e krijuar para se subjekti të merrte detyrën e prokurorit dhe jashtë ndikimit të subjektit në këtë funksion, nuk mundet të vendosin subjektin në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 33 pika 5 gërma b, i ndërlidhur me nenin 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur në konsideratë faktin që pasuria rezulton të jetë krijuar dhe ekzistuar para se subjekti i rivlerësimit të ishte emëruar në detyrën e prokurorit dhe me burime që duket se vijnë nga një aktivitet i ligjshëm. Problematikat e konstatuara lidhur me të ardhurat e prindërve ndër vite, janë situata, të cilat nuk duhet të rëndojnë me përgjegjësi

subjektin e rivlerësimit, nën dritën edhe të të gjitha rrethanave të tjera cituar më sipër, si dhe jurisprudencës së Kolegjit⁸.

3. *Sa i përket shkaqeve të ankimit lidhur me pasurinë: **Apartament banimi në përdorim***, pas vlerësimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në raport me aktet e depozituara në dosje të subjektit, në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, mbetën të provuara rrethanat faktike si më poshtë :

3.1 Subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ai nr. 84/2016, duke deklaruar përdorimin e pasurisë në Deklaratën Vetting, si dhe duke e deklaruar këtë pasuri si adresë banimi në deklaratat periodike vjetore dorëzuar në ILDKPKI që nga viti 2015.

3.2 Sikurse ka rezultuar gjatë hetimit administrativ në Komision, transaksionet për blerjen e kësaj pasurie janë kryer nëpërmjet llogarive/depozitave bankare të prindërve të subjektit të rivlerësimit. Pasuria apartament është blerë dhe regjistruar në pronësi 100% të nënës së subjektit të rivlerësimit dhe nga aktet në dosje provohet se ky i fundit, subjekti, nuk gëzon të drejta reale mbi këtë pasuri. Për më tepër, referuar procesverbalit për çelje testamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2023, të të atit të ndjerë të subjektit të rivlerësimit, rezulton se ai, i ka lënë trashëgimi subjektit të rivlerësimit, vetëm pasurinë apartament banimi me vendodhje në qytetin e Vlorës.

3.3 Referuar ligjit nr. 84/2016, neni 3/14 i tij, përkufizohen si “Persona të tjerë të lidhur”: *personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi*. Ndërsa neni 32/4 i po këtij ligji, parashikon detyrimin e subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

3.4 Në jurisprudencën e tij, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka trajtuar gjerësisht lidhjen e interesit që rrjedh nga një interes pasuror, referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 si dhe marrëdhënien që do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016⁹.

3.5 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në seancën e datës 24.9.2025, ka vlerësuar se në rastin objekt gjykimi, patur parasysh rrethanat specifike të rastit, konkluzionet do të vlerësohen në raport me provat dhe shpjegimet që do të administrohen gjatë shqyrtimit

⁸ Referohu jurisprudencës së Kolegjit, vendimit Nr. 20/2023 (JR) datë 3.5.2023.

⁹ Referohu vendimeve të Kolegjit, nr. Nr. 7/2020 (JR) datë 24.6.2020, prgrf 94; vendimi Nr. 21/2020 (JR) datë 10.9.2020, prgrf 74-75; vendimi Nr. 10/2022 (JR) datë 14.4.2022 prgrf 14.14-14.15; vendimi Nr. 18/2022 (JR) datë 8.6.2022.

gjyqësor në Kolegj, nisur nga nevoja që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga Kolegji, prapësimet dhe provat e administruara gjatë procesit të merren në konsideratë dhe të gjykohen prej tij, në mënyrë që të mos pamundësohet kontrolli i vendimit të Komisionit.

3.6 Në këto kushte, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, vlerësohet se për sa rezultat nga debati gjyqësor dhe shqyrtimi i çështjes në Kolegj, në konsideratë të rrethanave si: (i) deklaratimet koherente të subjektit të rivlerësimit në deklaratimet e tij pranë ILDKPKI-së, gjatë hetimit në Komision si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj sa i takon pasurisë në përdorim; (ii) krijimin e kësaj pasurie nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, që në momentin e blerjes (nënshkrimi i kontratave, konfirmimi i ekzekutimit të pagesave në rrugë bankare po nëpërmjet llogarive të prindërve); (iii) mungesën e të drejtave reale të subjektit mbi këtë pasuri, sikurse dëshmohet qartë dhe nga testamenti *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2023, dhe faktit se kjo pasuri rezulton në pronësi 100% të të ëmës së subjektit; (iv) historikut të investimeve të prindërve ndër vite, në pasuri të luajtshme e të paluajtshme; (v) sa trajtuar në fillim të këtyre bisedimeve mbi mungesën e informacioneve apo hetimeve të mëtejshme nga DPPP si dhe (vi) jurisprudencës së Kolegjit për rastet e pasurive në përdorim nga subjektet e rivlerësimit, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, *vlerësojmë* se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D pika 5 e aneksit të Kushtetutës.

3.7 *Në përfundim për kriterin e pasurisë*, nisur nga specifikat e rastit objekt gjykimi, duke marrë në konsideratë sa trajtuar gjerësisht më sipër mbi *pasurinë në përdorim* si dhe *momentin e krijimit të pasurisë depozitë bankare në pronësi* të subjektit të rivlerësimit, kohë përpara se ky i fundit të bëhej subjekt i deklaratimit të pasurive pranë ILDKPKI-së dhe kur nuk mbante ndonjë funksion publik por vazhonte studimet universitare e si rrjedhim, krijimi i saj nuk mund të rrjedhë apo lidhet me abuzimin ndaj një funksioni publik, vlerësojmë që problematikat e konstatuara e që lidhen me burimet e ligjshme të prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë depozitë në pronësi të subjektit, krijuar përpara detyrës, në kushtet kur këta të fundit nuk janë persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk janë të tilla që të justifikojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra apo të plotësojnë kushtet për konkludimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një deklaratimi të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

II. B Për vlerësimin e aftësive profesionale

4. Për *mosfillimin e çështjes penale që i përket kallëzimit penal nr. ****, viti 2019, me denoncues shtetasen **. *** në ankimin e Komisionerit Publik të datës 13.3.2024 është parashtruar se: [...] 20.8 ...Komisioneri Publik, vlerëson se arsyetimi i dhënë në këtë rast

nga subjekti i rivlerësimit, është i një cilësie të dobët dhe në kushtet e mungesës së një argumentimi logjik dhe ligjor, situatë faktike e cila vë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së prokurorit mbi materialin kallëzues, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 dhe vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket procedimit penal nr. ***/2019, nuk janë bindëse.[...]

4.1 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datë 17.9.2025, përcjellë në Prokurorinë e Posaçme me shkresën me nr. ***/** prot, datë **.9.2025, ndër të tjera shprehet se: [...] Gjykata e Apelit, në vendimin e saj ka zgjeruar dhe ndryshuar objektin e kallëzimit, duke e kualifikuar atë si veprën penale të shkatërrimit të pronës parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal- një objekti i rishikuar nga ajo që ishte referuar fillimisht nga Policia Gjyqësore dhe që nuk kishte qenë objekt i vlerësimit nga subjekti i rivlerësimit në kohën e ushtrimit të funksionit të tij... si dhe rezulton se deri më sot Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat nuk ka arritur të marrë një vendimmarrje përfundimtare për këtë çështje, ndonëse ajo është regjistruar mbi bazën e vendimit gjyqësor të formës së prerë që prej vitit 2023 [...] në momentin e regjistrimit të këtij procedimi penal kam çmuar se vepra penale e kryer nga shtetasi duhej të kualifikohej sipas nenit 278/2 të Kodit penal dhe jo sipas nenit 278/5 sepse në vlerësimin Tim për të kryer kualifikimin sipas figurës së veprës penale të parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni, duhet të vërtetoheshin njëkohësisht se transportimi është kryer me qëllim tregtimi, fakt i cili nuk provohet nga aktet e ndodhura në dosje.[...]

4.2 Në përfundim të gjykimit në Kolegj, marrë në vlerësim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, kërkimi për këtë procedim penal në ankimin e datës 13.3.2024 gjendet i bazuar, por duke vlerësuar mangësinë e konstatuar në **vetëm** këtë procedim penal, ajo është e tillë që nuk justifikon zbatimin e nenit 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

5. Për mosfillimin e materialit kallëzues me nr. *, viti 2016,** me denoncues shtetasit *** dhe *** ***, në ankimin e Komisionerit Publik të datës 13.3.2024 është parashtruar se: [...] ...vendimi i mosfillimit është marrë jashtë afatit 15-ditor, të përcaktuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, dhe pasi janë kryer disa veprime hetimore, në datat 26.4.2019 dhe datat 2 dhe 3 maj 2019, ku, ndër të tjera, janë administruar deklaratimet kontradiktorëve të palëve dhe akt-ekspertimi nr. **, datë **.9.2017, për të cilin subjekti ka disponuar se është kryer me dokumente fotokopje dhe jo origjinal. Për sa më sipër, duket se, dhe në rastin konkret ka elementë për t'u vlerësuar më së paku në drejtim të aspektit të arsyetimit në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, bazuar në tregues të tillë si struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e akteve të prokurorisë, cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit në përputhje me nenin 73, pika 2, e ligjit nr.

96/2016. Në rastin konkret, përtej qëndrimit përfundimtar që do sillnin rezultatet e hetimit të këtyre veprimeve hetimore, nga subjekti duket se nuk janë kryer veprime hetimore të logjikshme dhe të hollësishme, si ballafaqimi dhe verifikimi i thënieve kontradiktore të personave të përfshirë, apo përpjekje për të administruar dokumentin origjinal, për të realizuar akt ekspertimin, për qartësimin e rrethanave të kallëzimit.[...]

5.1 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në Kolegj në datë 17.9.2025, përcjellë në Prokurorinë e Posaçme me shkresën me nr. ***/** prot, datë **.9.2025, ndër të tjera shprehet se: [...] *jo vetëm që ekspertimi është privat, por edhe ekspertimi i paraqitur është kryer mbi një fotokopje, çka nuk përmbush kërkesat shkencore të kriminalistikës për të kryer një ekspertim teknik-grafik, për mungesë të gjurmës origjinale të shkrimit. Një qëndrim i tillë vjen si rrjedhojë e njohjes dhe zbatimit të praktikës së Gjykatës së Lartë ndër vite... se akt-ekspertimi është i pamundur të kryhet mbi fotokopje. Një qëndrim i tillë ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. **, datë **.2.2006, ku nuk pranon me cilësinë e provës një akt-ekspertimi grafik që vërteton falsitetin e nënshkrimit të bërë mbi një fotokopje*¹⁰ [...]. Ndërsa përsa lidhet me afatin 15 ditor të përcaktuar nga neni 290/1 i KPP, shprehet se: [...] *Ky është një qëndrim që është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë. Kolegji Penal ka konkluduar se: “kjo parregullsi e organit të procedimit penal-Prokurorit- e reflektuar në tejkallimin me disa ditë të afatit 15 ditor, të përcaktuar në neni 290 pika 1 e KPP- për t’u prononcuar lidhur me njoftimin e marrë nëpërmjet kallëzimit të paraqitur – disponimin prej tij të karakteristikave të “njoftimit për veprën penale”- të cilat do të detyronin këtë të fundit – organin e procedimit – për t’u aktivuar në mënyrë imediate për të regjistruar çështjen penale – nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të ligjshmërisë së vendimmarrje së tij, për mosfillimin e procedimit penal.*¹¹[...]

5.2 Në përfundim të gjykimit në Kolegj, marrë në vlerësim se vendimi i mosfillimit ka qenë objekt i kontrollit gjyqësor në shkallën e parë me të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** akti, datë **.7.2019¹² ka disponuar mbi këtë ankim, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe referencat në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë të lidhura drejtpërdrejt me shkaqet e ngritura në ankim, rezulton i shëruar shkakun ankimor i parashtruar në *ankimin e datës 14.2.2023* dhe në përfundim nuk konstatohen mangësi në aspektin e ndërmarrjes së hetimit në mënyrë logjike dhe të plotë për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësuar akuzën në gjyq.

¹⁰ Vendimi nr. ***, datë **.10.2012 i Gjykatës së Lartë.

¹¹ Vendimi nr. ***, datë **.5.2023 i Gjykatës së Lartë.

¹² Administruar në dosjen e Komisionit në formatin fotokopje dhe jo i plotë, si dokumentacion shoqërues i denoncimit të shtetasve **.dhe **.***.

6. *Për mosfillimin e çështjes penale që i përket kallëzimit penal të datës **.2.2019, me denoncues shtetasin *** ***, në ankimin e Komisionerit Publik të datës 13.3.2024 është bërë reference për çështjet e trajtuara më gjerësisht në rastin e ankimit datë 31.10.2023 të Institucionit të Komisionerëve Publikë. Sikurse parashtruam para Kolegjit në seancën gjyqësore publike të datës 24.9.2025, patur parasysh se në momentin e ankimit të datës 13.3.2024 nuk kishte gjykim nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit për ankimin e datë 31.10.2023 të IKP-së, dhe aktualisht me vendimin (JR) nr.44, datë 25.9.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për subjektin e rivlerësimit z.**.*** është disponuar edhe për këtë çështje, vlerësojmë se si rrjedhojë është shëruar shkaku ankimor që i përket denoncimit të shtetasit **.** në ankimin e datës 13.3.2024.*

III. KËRKIMI PËRFUNDIMTAR

7. Nga sa u parashtrua më sipër, në vlerësim të përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, ashtu sikurse dhe praktika ka treguar, kërkimi i ankimit i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit, mund të jetë alternativ kur rrethanat faktike dhe juridike e lejojnë atë.

8. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësimin tërësor të të gjitha provave të administruara dhe të rikonfirmuara gjatë shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor të kësaj çështjeje, bazuar në dispozitën e pikës 7 të nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66, pika 1 shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të vendosë:

- *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 736, datë 31.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gentian Habazaj”.*

DREJTUESI I PROKURORISË

PROKURORI I AUTORIZUAR

Altin DUMANI

Adnan XHOLI